

# Flutura e mëlçisë, një problem i nënvlerësuar në rritjen e gjedhit

Nga njëra anë, flutura e mëlçisë është një problem shpesh i padukshëm, vecanërisht në zonat e kullotjes, nga ana tjetër po merr rëndësi aty ku mbahen lopë me performancë të lartë, të cilat kanë nevojë për një mëlçi 100% të shëndetshme si organi metabolik kryesor!

Vitet e fundit Shërbimi Shëndetësor i Kafshëve në Austri ka kryer disa ekzaminime të mëlçisë. Mostrat e qumështit u moren nga rezervuaret e qumështit dhe u ekzaminuan për praninë e antittrupave kundër fluturës së mëlçisë. Në disa rajone u gjetën deri në 44% antitrupa.

## **Nje nga parazitët me dëmet më të medha ekonomike**

Pasojat negative të infektimit të lopëve nga flutura e mëlçisë janë nënvlerësuar. Humbjet evidentohen në rënie e prodhimit të qumështit, të mishit, si dhe në pjellorinë e lopëve. Lopët e infektuar nga mëlçia duhet të asgjësohet, për këtë arsye zvogëlohen të ardhurat nga therja. Flutura e mëlçisë (*Fasciola hepatica*) paraziton në rrugët biliare dhe shkakton inflamacion të kanaleve biliare, kjo shoqërohet me trashjen e tyre.

Shenjat klinike të sëmundjes janë të rralla. Konsumi i reduktuar i ushqimit, ripërtpja, lodhje dhe ulje të performancës vihen re sidomos gjatë muajve të dimrit.

## **Zhvillimi i fluturës të mëlçisë**

Flutura e mëlçisë me gjatësi 1-3 cm shtrojnë në mëlçi deri në 20,000 vezë në ditë, të cilat ekskretohen përmes jashtëqitjes. Kur vezët janë pastruar nga grimcat e jashtëqitjeve nëpërmjet ujit (pellgje të vegjel uji, gjurmë të mbushura më ujë në afërsi të korbave ose grazhdit të bagëtive), larvat çelin dhe merren nga kermijtë e baltës (mikpritës i ndërmjetëm).

Ky lloj kërmilli jeton në zona të lagështa, të cilat mbajnë ujë gjate gjithë vitit, të tilla si në përrenj, kulluese uji të hapura, pellgje etj. Pas nje zhvillimi prej dhjetë deri në dymbëdhjetë javësh, larvat largohen nga kërmilli. Riprodhimi i kërmijve që prodhojnë larva rrit rrezikun e infeksionit për

bagetitë që kullotin në këto ambiente. Muajt maj dhe qershor konsiderohen si periudha kryesore e transmetimit të fluturës së mëlçisë gjatë periudhës së kullotjes.

## **Infeksioni dhe diagnoza**

Infeksioni ndodh përmes gëlltitjes së larvave infektive (metacercaria= larvat e kapsulës) me ushqimin.

Nga larvat e gëlltitura, zhvillohen vezë të reja që shpojnë murin e zorrevë dhe hyjnë në mëlçi. Atje, brenda gjashtë deri në tetë javë rriten duke u zhvilluar në fluturat e mëlçisë, që depërtojnë në kanalet biliare. Flutura e mëlçisë zbulohet gjatë therjes, me anë të analizës së feçes, e cila është e pasigurtë, sepse vezët nuk ekskretohen vazhdimisht, si dhe nëpërmjet zbulimit të antitropave kundër fluturës së mëlçisë (testi RISA) në qumësht ose në gjak, të cilët japin informacion për nivelin e infektimit dhe efektet e dëmshme.

## **Luftimi**

Për të zvogëluar dëmtimin e shkaktuar nga flutura e mëlçisë duhet të merren disa masa të kombinuara me njëra tjetrën si p.sh. masat e higjienës së kullotave (kullimi, tubacionet, rrethimi), masat e higjienës së ushqimit (përgatitja e silazhit nga zonat foragjere të kolonizuara nga kermijtë e baltës; ushqimi i sojës nga zonat e kolonizuara nga kërmijtë e baltës duhet të konsumohet vetëm pas 4- 6 muaj ruajtje) si dhe trajtimet medicinale.

Në dispozicion për trajtim janë disa substanca aktive (Triclabendazole, Albendazel, Netobimin), por duhet të merren parasysh edhe situatat kur krijohet rezistencë. Përbërësit e rinj aktivë (p.sh. Closantel) në kombinim kanë provuar të jenë shumë efikas në trajtim.

Është e rëndësishme të kryhet një trajtim në pranverë (8 jave para daljes në kullota - parandalimi i sekretimit të vezëve në livadh) dhe një trajtim në vjeshtë (8-10 javë pas vendosjes në stalla - trajtimi i infeksioneve të fluturës së mëlçisë).

Abb.: Der Entwicklungszyklus des Großen Leberegels erfolgt über die Zwergschlamm Schnecke als Zwischenwirt




Figura 1: Cikli i zhvillimit të fluturës së mëlçisë zhvillohet përmes kërmijve të baltës, të cilët luajnë një rol të ndërmjetëm

Tabela 1: Vlerësimi dhe interpretimi i rezultateve të testit ELISA për zbulimin e antitropave kundër mëlçisë në qumësht dhe gjak

< 0,3	NEGATIV	Ekspozim i vogël ose aspak i mëlçisë
0,3 – 0,6	Lehtëshëm pozitiv	Kontakti me mëlçinë është i pranishëm
≥ 0,6	POSITIV	Infeksion me fluturën e mëlçisë, me shumë mundësi ulje e performancës

### Masat parandaluese kundër fluturës së mëlçisë

Përveç trajtimit të gjedhit kundër fluturës së mëlçisë, duhet të merren gjithmonë masa për higjienën e kullotave dhe të ushqimit për të kontrolluar kërmijtë si një mikpritës i ndërmjetëm dhe të gjitha fazat e zhvillimit të fluturës së mëlçisë.

### Higjiena e kullotave

- Stendat e ngritura, gropa kulluese për ujë të pijshëm, korita
- Drenazhim i rrjedhave ujore dhe pellgjeve
- Shmangni pirjen e ujit nga kafshët nga mjedise ujore në natyrë

- Thani pellgjet e lagura
- Ndryshimi i kullotave dhe kositja
- Pas kullotjes së vjeshtës, siguroni prerjen e parë në pranverë
- Mos i mbani viçat e rinj në një kullotë me ato më të vjetrit
- Kullotje me rotacion - kthehu pas 32 ditësh
- Ndryshimi i kullotave në fund të qershorit / fillimi i korrikut është në kullotat e mbjella me parë
- Plehu nga tokat ku kanë kullotur lopët: ruajeni së paku 60 ditë (në verë) ose 90 ditë (në dimër) para përdorimit; prisni më shumë së 30 dite pas aplikimit për të kullotur lopët; Plehu organik në kullota (sanë / silazh) është gjithmonë i mundur
- Ruajeni plehun për më shumë se 2 muaj para se ta përdorni

### **Masa të përgjithshme**

- Minimizoni stresin
- Furnizimi me vitamina dhe mikro-makro elemente

### **Higjiena e ushqimit**

- Metacarkariet (larvat e kapsules) mbijetojnë disa muaj nga thatësira, prandaj sana ruhet për gjashtë muaj nga prerja e parë deri në ushqyerje; asnjë prodhim sanë nga kullotat e rrezikuara (deri në 6 muaj)

Silazh i saktë vret metacarkariet brenda 4 javësh, pra sigurimi i rritjes së zonave të rrezikut si dhe shkurtimet e 3-të dhe ato në vijim..

- **Trajtimi i viçave**

Antiparazitoza e planifikuar për të zvogëluar riskun nga infeksioni:

- Në pranverë: 8 jave pas kullotjes
- Në vjeshtë/dimër: 8 deri në 10 javë pas strehimit deri në fund të strehimit
- Trajtim çdo 10 javë kur janë në kullotje
- Disa cikle trajtimi gjatë disa viteve kur është e nevojshme
- Trajtimi gjithmonë në lidhje me kullotat dhe masat e higjienës së ushqimit
- Trajtoni të gjithë tufën dhe të gjitha kafshët e blera